



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHQITIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Prill 2022

4

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



NDAHEN CERTIFIKATAT PËR TË RINJË NGA PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS

Në kuadër të Thirrjes së Gjashtë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, më 4 prill, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me ministren e Arsimit dhe Sportit kanë ndarë certifikatat për 196 të rinjtë, të cilët përfunduan me sukses praktikën e punës pranë institucioneve përkatëse.

Nga ky program, i cili u ofron të rinjve të diplomuar mundësinë për t'u njohur me tregun e punës dhe për të fituar eksperiencën fillestare pranë një institucioni të qeverisjes qendrore apo vendore, institucioni të pavarur apo shoqëri tregtare, **përfunduan praktikën e punës 572 të rinj dhe 196 prej tyre u punësuan** në institucionet pritëse. Përveçse një eksperiencë shumë e vlefshme për zhvillimin e aftësive profesionale, akademike dhe personale, praktika e punës iu vlen të rinjve pjesëmarrës edhe si përvojë e njohur pune në çdo aplikim të mëtejshëm. Së shpejti do të hapet **thirrja e re për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës**.



NIS PROJEKTI I SHKËMBIMIT "SUPERSHKOLLAT" KU TË RINJË SHQIPTARË MIKPRESIN TË RINJË E RAJONIT

Projekti "Supershkollat", falë të cilit po zhvillohen shkëmbime rinore mes nxënësve të Ballkanit Perëndimor, ka bërë bashkë në Shqipëri, nxënësit e gjimnazit "Qemal Stafa" me të rinjtë nga shkolla "Meša Selimović" e Bosnjë dhe Hercegovinës. Nëpërmjet aktiviteteve artistike si këngë, valle e piktura, si dhe panairit me punime nga klubet shkollore, të rinjtë nga Bosnjë dhe Hercegovina patën mundësinë të njihen me vlerat dhe traditat shqiptare, si dhe të ndajnë me bashkëmoshatarët e tyre informacione të fushave të ndryshme. Gjatë muajit prill, **8 shkolla nga Ballkani Perëndimor** janë mirëpritur nga të rinjtë e Elbasanit, Tiranës, Rrëshenit, Shkodrës, Dervicanit, Pogradecit dhe Kamzës. Projekti është një nismë e **Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (RYCO)** dhe e mbështetur nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, që përfshin një

skemë shkëmbimesh të nxënësve dhe mësuesve midis shkollave të rajonit dhe iu jep atyre mundësinë të udhëtojnë në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, të fitojnë njohuri shtesë dhe të ndërtojnë bashkëpunime dhe miqësi të reja.



KONFERENCA E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR STRATEGJINË E RE PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në punimet e konferencës për përgatitjen e **Strategjisë së Re të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës**, mbajtur më 7-8 prill, në Romë, Itali. Përfaqësuesit e nivelit të lartë nga **46 vendet anëtare të Këshillit të Evropës** diskutuan mbi gjashtë objektivat strategjike për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët prezantoi politikat dhe **masat konkrete të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare** në këtë drejtim, në përputhje edhe me agjendën 2030 të vendit.

Dëgjimi i zërit të të rinjve në kuadër të sesioneve konsultuese me ta për Strategjinë Kombëtare të Rinisë, **ngritja e 3 qendrave** për mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve

nga dhuna sipas modelit evropian Barnahaus, **përfshirja e mësuesve ndihmës** në sistemin arsimor dhe zhvillimi në shkolla i **programit jashtëshkollor**, ishin disa nga arritjet e prezantuara. Gjithashtu u prezantuan edhe nismat konkrete në kuadër të digjitalizimit dhe inovacionit, si kodimi në klasë të parë dhe siguria në rrjet apo **mbrojtja nga bullizmi online**.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Prill 2022

4

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



PROGRAMI FLAMUR I BE-SË "GARANCIA RINORE"

Gjatë muajit prill u zhvillua takimi i Grupit Ndërinstitucional për instrumentin e **Garancisë Rinore** në Shqipëri, i organizuar me mbështetjen e projektit të BE-së "Asistenca Teknike për të Mbështetur Reformën mbi Politikat e Punësimit, Arsimit dhe Formimin Profesional (SREP-VET)".

Në këtë takim u bë njohja me instrumentin e Garancisë Rinore, u prezantua progresi i arritur deri më sot dhe u diskutuan çështje të tjera të lidhura me **përgatitjen dhe hartimin e Planit Zbatues të Garancisë Rinore**.

Ky do të jetë një **program i dedikuar për të rinjtë që nuk janë në punësim, arsimim apo trajnim**, duke synuar identifikimin dhe regjistrimin e tyre në skemë, me qëllim dhënien e një ofertë punësimi, praktike profesionale, edukimi apo trajnimi **brenda katër muajve** nga data e regjistrimit. Grupi Ndërinstitucional do të ndjekë në vijim hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Garancisë Rinore, për tu finalizuar me fillimin e projektit në gjysmën e dytë të vitit 2022.



JETËSOHEN PROJEKTET E FINANCUARA NGA AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Të rinjtë e projektit "**Fuqizimi i të rinjve pas pandemisë: Sfidat dhe mundësitë**", që financohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) në kuadër të thirrjes së parë të AKR-së për projekt-propozime për rininë, dhe i zbatuar nga Qendra Evropiane, janë bërë pjesë e aktivitetit të zhvilluar në Korçë, për të rritur **ndërgjegjësimin në përballimin e pasojave post COVID-19 në aspektin emocional dhe psikologjik**. Si dhe për të forcuar kapacitetet e të rinjve nëpërmjet zhvillimit të potencialit personal.

Një tjetër projekt që po zhvillohet me mbështetjen e AKR-së është dhe projekti "**Dua më shumë Natyrën dhe Shqipërinë**", që zbatohet nga organizata "The Door" dhe ka si qëllim fuqizimin e **30 të rinjve për jetesën e pavarur dhe miqësore në natyrë**.

Po ashtu, në kuadër të projektit "Sporti dhe Edukimi Frymëzohj" i zbatuar nga shoqata "Skills", u zhvillua aktiviteti "**Ted Talk Cërrik**", i cili konsistoi me një bisedë të hapur, me fokus **qasjen e të rinjve ndaj suksesit në aspektin personal dhe profesional**.



ZHVILLOHET TAKIMI I GRUPIT TË DEPUTETËVE "MIQTË E FËMIJËVE"

Më 15 prill u mbajt takimi i **Grupit të Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve"**, nën drejtimin e kryetares së Kuvendit, së bashku me ministren e Arsimit dhe Sportit, dhe zv. ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale diskutuam mbi mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të të miturve, si një ndër prioritetet kyçe të Qeverisë shqiptare. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët diskutoi rreth rëndësisë së **fuqizimit të mekanizmave për kontrollin dhe parandalimin e dhunës në ambientet shkollore**, duke krijuar kështu një mjedis edukimi të sigurt për të rinjtë dhe fëmijët.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, u përmend nevoja për **praninë e shtuar të psikologëve në shkolla**, si kërkesë specifike e dalë gjatë procesit të konsultimeve me të rinjtë. Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përkatëse është angazhuar për krijimin e një **aplikacioni mobile në mbrojtje të fëmijëve nga rreziqet e internetit**, që do t'i mundësojë atyre të denoncojnë kërcënimet dhe të komunikojnë situatat ku ndodhen, për të parandaluar rreziqet.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi